



Në bazë të nenit 94, paragrafi 1, pika 43, e lidhur me nenin 97, paragrafi 3 të Ligjit për Arsimin e Lartë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 178/21 dhe nenin 161 të Statutit të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup (Informatori Universitar nr. 4/2019), Senati i Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup shpall

KONKURS PUBLIK

për zgjedhje të rektorit të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup
për periudhën mandatare 26.04.2022 deri në 25.04.2025

1. Kushtet për zgjedhje të rektorit:
 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
 - Të jetë nga rradhët e profesorëve ordinar;
2. Konkursi zgjat 7 (shtatë) ditë pune duke llogaritur nga dita e shpalljes së konkursit në gazetata ditore dhe në web faqen e Universitetit.
3. Kandidati i cili paraqitet në konkursin publik, deri te Komisioni universitar zgjedhor duhet të dorëzojë:
 - Fletparaqitje;
 - Programën e punës;
 - Të dhëna biografike dhe bibliografike;
 - Vendim për zgjedhje në thirjen profesor ordinar;
 - Certifikatën e shtetësisë;
 - Tre rekomandime të besueshme;
 - Deklaratë se kandidati nuk është ushtrues i ndonjë funksioni tjetër publik ose funksioni në parti politike;
 - E-postën;
 - telefon për kontakt.
4. Dokumentacioni dorëzohet:
 - Në origjinal ose kopje e vërtetuar në noter me dorëzim personal në Arkivën e Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, në rr. "Mirçe Acev" nr. 4/ kati i shtatë, Shkup, çdo ditë pune nga ora 9:00 deri në ora 16:00, deri te Komisioni universitar i konkursit me shënimin: "për konkursin publik për zgjedhje të rektorit", si dhe
 - Në formë elektronike deri në ora 24:00 në ditën e fundit (me datë 28.02.2022), në postën elektornike në vijim: kuz@unt.edu.mk. Nëse kandidati ka nënshkrim elektronik të lëshuar nga dhënësi të autorizuar të nënshkrimeve elektronike në RMV (KIBS ose Telekom i Maqedonisë), dokumentet i nënshkruan me atë, në të kundërtën dorëzon dokumente të skanuara në PDF format, të nënshkruara me nënshkrimin personal të tij.

Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup
Komisioni Universitar Zgjedhor